



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**  
**Komuna e Rahovecit**  
**Opština Orahovac / Municipality Rahovec**  
**Njësia e Auditimit të Brendshëm**



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC  
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNES / KABINET PREDSEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)  
Nr./Br./No 5152 Nr. i faq./Br.str./No.pg 18  
Data/Datum/Date 06.01.25  
RAHOVEC / ORAHOVAC

# RAPORT VJETOR I PUNËS

Për periudhën Janar - Dhjetor, 2024

06.01.2025

## Raporti i punës së NJAB-së për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2024

Në periudhën Janar – Shtator, Njësia e Auditimit të Brendshëm për punën e vet, është bazuar kryesisht në Planin vjetor të punës për vitin 2024, i cili plan është i aprovuar nga Kryetari i Komunës së Rahovecit.

Ndërsa bazë ligjore ka pasur Ligjin Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, Udhëzimet Administrative për Auditim të Brendshëm, Doracakun e Auditimit të Brendshëm, Statutin e Auditimit të Brendshëm dhe Instruksionet lidhur me Standardet Ndërkombëtarë të Auditimit të Brendshëm.

Sipas Planit Vjetor të NJAB-së, për periudhën: Janar – Dhjetor të vitit 2024, kemi arritur të kryejm 6 auditime.

### Drejtoritë e audituara të Planifikuara dhe të realizuara për periudhën Janar – Dhjetor të vitit 2024

1. Auditimi i Brendshëm në Zyrën e Prokurimit.
2. Auditimi i Performancës, subvencionet në drejtorin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.
3. Auditimi i Brendshëm në drejtorinë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.
4. Auditimi i Brendshëm në drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
5. Auditimi i Brendshëm në drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.
6. Auditimi i Brendshëm në drejtorinë për Financa dhe Buxhet.

### Aktivitetet dhe angazhimet e tjera të Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Angazhimet tona kryesisht kanë qenë:

- Vlerësimi i objektivave për auditime, sipas shkallës së rrezikshmërisë, është pregaditur Plani Strategjik i NJAB për vitet 2025 – 2027, dhe Plani Vjetor i Punës së NJAB-së për vitin 2025.
- Është pregaditur raporti i gjashtëmujorit të parë për vitin 2024, i është dorëzuar Njesisë Qendrore për Harmonizim të Auditimit të Brendshëm (NjQHAB) dhe Kryetarit të Komunës.
- Verifikimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna në periudhën Janar – dhjetor të vitit 2024.
- Gjithashtu NJAB-ja ka pasur angazhime me të gjithë zyrtarët të cilët me një formë ose tjetër kanë qenë të kyçur në procesin e implementimit të rekomandimeve.

Udhëheqësi i NJAB-së

Ruzhdi Kabashi

